



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-p.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/225
Datë: 30.5/2025

Senati i Universitetit të Prishtinës, në kuadër të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 147, pika 3.9 të Statutit të UP-së, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Rregulloren me nr. 2/254, datë 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve të angazhuar për ligjërata dhe ushtrime në Universitetin e Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.5.2025, vendosi të shpallë:

THIRRJE PUBLIKE

Për angazhim të profesorëve dhe asistentëve të angazhuar për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës për vitin akademik 2025/26.

Angazhimi me honorar i profesorëve dhe asistentëve të angazhuar për ligjërata dhe ushtrime do të bëhet sipas propozimit të njësive akademike, në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë, dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës, Rregulloren me nr. 2/254, datë 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve të angazhuar për ligjërata dhe ushtrime në UP, Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim si dhe standardet e miratuara nga AKA-ja dhe Rregulloren në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UP-së.

I. Procedura e angazhimit sipas konkursit dhe përjashtimet për kategoritë e caktuara

Procedura e angazhimit të **profesorëve dhe asistentëve** të angazhuar për ligjërata dhe ushtrime nëpërmjet shpalljes së **THIRRJES PUBLIKE**, bazuar në Rregulloren me nr. 2/254, datë 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.

II. Kushtet e angazhimit

1. Personat e angazhuar në cilësinë e profesorëve dhe asistentëve të angazhuar nuk marrin thirrje akademike. Angazhimi i tyre bëhet bazuar në procedurat specifike të përcaktuara në Rregulloren me nr. prot. 2/254, datë 17.7.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve të angazhuar në UP.
2. Me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit dhe nepotizmit në Universitetin e Prishtinës, nuk mund të angazhohen kandidatët që kanë të punësuar apo të angazhuar në njësinë akademike përkatëse persona në marrëdhënie familjare (në relacionin prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).
3. Për pozitën e **profesorit** të angazhuar për ligjërata, kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 - Të ketë të paktën gradën shkencore Master i shkencave/arteve¹, ndërsa kandidatët me gradën Doktor i shkencave, nga lëmi përkatës (në Fakultetin e Arteve ekuivalente me të), kanë përparësi.
 - Të ketë së paku 1 publikim në revistat shkencore ndërkombëtare (në Fakultetin e Arteve së paku 1 vepër artistike të rangut ndërkombëtar në fushën përkatëse). Për pozitën e **profesorit** të angazhuar për ligjërata në Mjekësi, në lëndët klinike, kandidati duhet të jete specialist i fushës përkatëse.

¹ Kandidati me gradën shkencore Master duhet të ketë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet e studimit

4. Për pozitën e **asistentit** të angazhuar për ushtrime, kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:
- Të ketë të përfunduar studimet master ose ekuivalente me të në fushën përkatëse.
 - Të ketë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet e studimit.
 - Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinës (në lëndët klinike të veterinarisë) dhe në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (në lëndët laboratorike²) kandidati duhet të dëshmojë që ka së paku 3 vjet përvojë pune profesionale në fushën përkatëse.
 - Në Fakultetin e Mjekësisë (në lëndët klinike), të ketë të përfunduar specializimin ose të jetë së paku në vitin e tretë të specializimit në fushën përkatëse. Angazhimi bëhet duke marrë parasysh edhe Ligjin e Shëndetësisë.
 - Në Fakultetin Ekonomik, për ushtrimet në lëndët e kontabilitetit dhe auditimit, kandidati duhet të jetë kontabilist, përkatësisht auditor i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi dhe të ketë së paku 3 vjet përvojë pune profesionale në fushën përkatëse.
5. Bazuar në Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, vlerësimi dhe propozimi i kandidatëve për emërim bëhet nga komisioni vlerësues.

III. Fondi i orëve për të angazhuarit

1. **Profesorët** e jashtëm për ligjërata dhe profesorët vizitorë mund të mbajnë deri në **6** orë në javë.
2. **Asistentët** e jashtëm për ushtrime mund të mbajnë deri në **10** orë në javë.

IV. Periudha e angazhimit dhe kompensimi

1. Angazhimi i profesorëve dhe asistentëve bëhet për një semestër, përkatësisht për dy semestra të të njëjtit vit akademik, ndërsa kontrata lidhet për vitin akademik përkatës.
2. Pas vlerësimit pozitiv për profesorë dhe asistentë, me propozim të dekanit, angazhimi mund të vazhdohet edhe për 1 vit akademik, jo më shumë se dy vite tjera (4 semestra), pa shpallur thirrje publike. Propozimi i arsyetuar i dekanit duhet të miratohet në senat.
3. Kompensimi për angazhim bëhet në bazë të orëve të realizuara, respektivisht për semestrin/at për të cilët angazhohet për mbajtjen e ligjëratave/ushtrimeve, sipas kohëzgjatjes së semestrit të bazuar në Statutin e UP-së.
4. Vlera e kompensimit të profesorëve dhe asistentëve të angazhuar është e përcaktuar në Rregulloren për të ardhura personale të personelit akademik, e cila është në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës.
5. I angazhuari ka për obligim që në kuadër të kontratës të mbajë provimet për të gjitha afatet brenda vitit përkatës akademik.
6. I angazhuari, nëse ka titullin Dr. Sc. ose ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve, ka të drejtë të mentorojë kandidatët në nivelin Bachelor.
7. I angazhuari mund të jetë anëtar i komisionit për mbrojtjen e temave në nivelin bachelor dhe master.

V. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

Kandidatët që aplikojnë për profesorë dhe asistentë të angazhuar duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- a) Kërkesën për aplikim;
- b) Biografinë (CV);
- c) Certifikatën/ekstraktin e lindjes;
- d) Kopjen e diplomës përkatëse të vërtetuar me vulë origjinale nga noteri, për pozitën që aplikon;
- e) Kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit me rastin e aplikimit për angazhim duhet të ngarkojnë vendimin për nostrifikim (barasvlerë) të diplomës përkatëse (bachelor, master, magjistraturë, doktoratë).

² Lista e lëndëve klinike të Fakultetit të Mjekësisë, lëndëve klinike të fushës së veterinarisë, lëndëve laboratorike të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe lëndët e kontabilitetit dhe auditimit në Fakultetin Ekonomik është e publikuar në web faqen e Universitetit të Prishtinës dhe të fakulteteve përkatëse.

- f) Kandidatët, të cilët konkurrojnë për pozitën e **asistentit** të angazhuar për ushtrime, lektorit dhe korepetitorit duhet të sjellin edhe certifikatën origjinale të notave të studimeve bachelor dhe atyre master, ose kopjen e noterizuar me vulë origjinale nga noteri;
- g) Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale;
- h) Dëshmitë eventuale për angazhimet paraprake në UP ose në ndonjë institucion të akredituar të arsimit të lartë.
- i) Dëshmi të lëshuar nga gjykata kompetente, përmes së cilës dëshmohet që kandidati nuk është i dënuar.
- j) Dëshmi tjera relevante për pozitën në të cilën aplikon.

VI. Komisioni vlerësues dhe e drejta e ankesës

1. Për formimin e komisionit vlerësues dhe procedurat e implementimit vlejné dispozitat e Rregullores me nr. 2/254, datë 17.07.2024.
2. E drejta e ankesës dhe afatet e ankesës janë të përcaktuara me dispozitat e Rregullores me nr. 2/254, datë 17.07.2024.
3. Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese pranë komisionit për ankese në fakultetin përkatës, brenda 5 ditëve nga publikimi i raportit të Komisionit vlerësues në web-faqe.
4. Vendimi i këshillit të fakultetit, me listën e kandidatëve të pranuar si profesorë dhe asistentë të angazhuar, dërgohet në Senat për informim.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në versionin elektronik brenda afatit të thirrjes publike, në adresën elektronike në vijim: angazhimi@uni-pr.edu dhe në adresat elektronike të njësive akademike si në vijim:

Fakulteti Filozofik: konkurs.filozofiku@uni-pr.edu
FSHMN: konkurs.fshmn@uni-pr.edu
Fakulteti i Filologjisë: konkurs.filologjia@uni-pr.edu
Juridiku: konkurs.juridiku@uni-pr.edu
Ekonomiku: konkurs.ekonomiku@uni-pr.edu
FIN: konkurs.fin@uni-pr.edu
FIEK: konkurs.fiek@uni-pr.edu
FIM: konkurs.fim@uni-pr.edu
Fakulteti i Mjekësisë: konkurs.mjekesia@uni-pr.edu
Fakulteti i Arteve: konkurs.arte@uni-pr.edu
FBV: konkurs.fbv@uni-pr.edu
FEFS: konkurs.fefs@uni-pr.edu
Fakulteti i Edukimit: konkurs.edukimi@uni-pr.edu
Fakulteti i Arkitekturës: konkurs.fa@uni-pr.edu

Aplikimet hartohen nga vet kandidatët, sipas pozitës dhe fakultetit ku dëshirojnë të aplikojnë.

Një aplikim bashkë me dokumentacionin relevant duhet të dërgohet në emailin angazhimi@uni-pr.edu dhe i njëjti në emailin e fakultetit ku aplikon kandidati, sipas emailave përkatës, të publikuara në këtë thirrje publike.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Thirrja publike publikohet në faqen zyrtare të UP-së <https://www.uni-pr.edu>, dhe në web-faqet e njësive akademike përkatëse, duke filluar nga data 30 maj 2025. **Aplikimi do të jetë i hapur nga data 30 maj deri më 9 qershor 2025.**

Thirrja publike shpallet sipas propozimeve të njësive akademike dhe atë si në vijim:

I. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

1. Tre asistentë të angazhuar për ushtrime për grup lëndësh nga Matematika;
2. Tre asistentë të angazhuar për ushtrime për grup lëndësh nga Shkenca Kompjuterike.

II. FAKULTETI I ARKITEKTURËS

1. Një profesor i angazhuar për lëndën: Gjuhë Angleze (Arkitekturë, BSc, O);
2. Një asistent/e i/e angazhuar për lëndët: Arkitektura dhe Gjeometria (Arkitekturë, BSc, O); Vizatimi i Lirë dhe Estetika e Hapësirës (Arkitekturë, BSc, O); Reprezentim Arkitektonik (Arkitekturë, BSc, O); CAD (Arkitekturë, BSc, O); Projektimi Ndërdisiplinar (Arkitekturë, MSc, O); Modelimi 3D i Ndërtesës (EE, MSc, Z);
3. Një asistent/e i/e angazhuar për lëndët: Bazat e Projektimit 1 (Arkitekturë, BSc, O); Projektimi 2 – Objektet Shumëbanesore (Arkitekturë, BSc, O);
4. Një asistent/e i/e angazhuar për lëndët: Bazat e Projektimit 2 (Arkitekturë, BSc, O); dhe Projektim 1 - Banim Individual (Arkitekturë, BSc, O);
5. Një asistent/e i/e angazhuar për lëndët: Projektim 6 - Objektet Administrative - Afariste (Arkitekturë, BSc, O); Projektim 8 - Objektet Edukative - Arsimore (Arkitekturë, MSc, O); Projektim 9 - Objektet e Sportit dhe Rekreimit (Arkitekturë, MSc, O); STUDIO – Objektet Shëndetësore (Arkitekturë, MSc, Z); Projektim – Kultura (Arkitekturë, MSc, O); Projektim - Objektet Polifunkionale (Arkitekturë, MSc, O); Projektimi në Kontekst Kulturor (Arkitekturë, MSc, Z);
6. Një asistent/e i/e angazhuar për lëndët: Projektim - Komplekset e parkimit stacionar (Arkitekturë, BSc, Z); Projektim 4 - Ndërtesat Komerciale dhe Tregtare (Arkitekturë, BSc, Z); Projektim 5 - Komplekset Industriale (Arkitekturë, BSc, O);
7. Një asistent/e i/e angazhuar për lëndët: Sistemet Bashkëkohore të Ndërtesave 1 (Arkitekturë, BSc, O); Metodologjia e Hulumtimit në EE në Ndërtesa (EE, MSc, O); Projektimi i Sistemeve me EE në Ndërtesa (EE, MSc, O);
8. Një asistent/e i/e angazhuar për lëndët: Energjia dhe Ndërtesa (EE, MSc, O); Inxhinieria Hidroteknike, Mekanike dhe Elektrike në Ndërtesa (EE, MSc, Z); Projektimi i Ndërtesave Pasive Diellore (EE, MSc, O); Projektimi i Ndërtesave me Eficiencë të Energjisë (EE, MSc, O); Certifikimi i Performancës së Energjisë në Ndërtesa (EE, MSc, Z).

III. FAKULTETI I FILOZOFIK

1. Një profesor i angazhuar për ligjërata për lëndët: Antropologji e gjinisë (O) 3 orë;
2. Një profesor i angazhuar për ligjërata për lëndët: Antropologjia e Evropës Juglindore (O) 3 orë;
3. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Histori Botërore Mesjetare I (O); Histori Botërore Mesjetare II (O); Histori e qytetërimit modern (O); Histori ekonomike e Ballkanit XIX- XX 4+4 orë;
4. Një asistent i angazhuar për ushtrimet për lëndët: Hyrje në Antropologji (O), Teoritë Antropologjike (O), Metodot dhe teknikat e hulumtimit (O), Migrimi dhe siguria sociale (O) 8+2 orë;
5. Një asistent i angazhuar për ushtrimet për lëndët: Etnologji Shqiptare (O), Antropologji e gjinisë (O), Antropologji vizuale (O), Trashëgimia dhe Mjedisi, Dizajnimi i projekteve kulturore (O), Veshje dhe Identiteti (O) 4+6 orë;
6. Një asistent i angazhuar për ushtrimet për lëndët: Struktura dhe organizimi shoqëror (O), Familja dhe faretësia (O), Antropologjia e Evropës Juglindore (O), Antropologjia e kulturës buknore (O) 8 orë;
7. Një asistent i angazhuar për ushtrimet për lëndët: Hyrje në sociologji (O), Sociologji e

sportit (Z), Teoritë klasike të sociologjisë (O), Teoritë bashkëkohore të sociologjisë (O), Sociologji e identitetit (O) 8+6 orë;

8. Një asistent i angazhuar për ushtrimet për lëndët: Metodot kuantitative në sociologji (O), Lëvizjet shoqërore dhe protesta (O), Praktikum i sociologjik (O), Metodot kualitative në sociologji (O), Sociologji politike (O), Shkenca, teknologjia dhe shoqëria (Z), Edukimi qytetar dhe demokracia (O) 9+10 orë;
9. Një asistent i angazhuar për ushtrimet për lëndët: Sociologji e religjionit (Z), Antropologji Sociale (Z), Sociologji e punës (O), Krimi dhe kontrolli shoqëror (Z), Mendimi social shqiptar (O) 6+4 orë;
10. Një asistent i angazhuar për ushtrimet për lëndët: Shkrim akademik (O), Sociologji e arsimit (Z), Sociologji e shëndetit dhe sëmundjes (Z), Të drejtat e njeriut dhe drejtësia sociale (Z), Mendimi social bashkëkohor (O), Mjedisi dhe shoqëria (Z), Sociologji e jetës së përditshme (Z) 8+8 orë;
11. Një asistent i angazhuar për ushtrimet për lëndët: Analizë e politikës së jashtme (O), Politika në Lindjen e Mesme (O), Qeverisja dhe shteti (Z), Politikat publike (O), Organizata ndërkombëtare (O), Çështjet gjinore dhe politika (Z), Teoritë politike bashkëkohore (O), Shoqëria civile dhe demokracia (O) 6+5 orë;

12. Një asistent i angazhuar për ushtrimet për lëndët: Sistemi politik i Kosovës (O), Hyrje në politikën krahasimtare (O), Mediat dhe politika (O), Qeverisja lokale (Z), Administrate publike krahasuese (O), Globalizimi dhe integrimet rajonale (Z), Historia botërore bashkëkohore (Z), Politikat e vendeve në zhvillim (Z), E drejta dhe politika (Z) 7+5 orë;
13. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Histori e Filozofisë II - Empiricizmi dhe Racionalizmi (O); Histori e Filozofisë III - Idealizmi klasik gjerman (O); Hyrje në ideologjitë bashkëkohore (O); Hegeli dhe filozofia e shek. XIX; Hyrje në metafizikë dhe ontologji (O); Filozofi e shkencës (O); Filozofi e logjikës (O); Logjikë deduktive (O) 8+8 orë.

IV. FAKULTETI I EDUKIMIT

1. Një profesor i angazhuar për ligjërata për lëndën: Vlerësimi në arsim (3 specializime MA);
2. Një profesor i angazhuar për ligjërata për lëndët: Filozofi e edukimit (4 specializime MA);
3. Një profesor i angazhuar për ligjërata për lëndët: Didaktika, epistemologjia dhe hyrje në edukimin STEAM; Praktika mësimore për STEAM, Dizajni, zhvillimi dhe vlerësimi i kurrikulave në edukimin STEAM (MA);
4. Një profesor i angazhuar për ligjërata për lëndët: Teknologjitë e edukimit dhe mësim elektronik (2 specializime MA);
5. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Komunikimi në arsim (4 specializime); Vlerësimi në arsim (4 specializime MA); Vlerësimi në arsim (Ba. Fillor);
6. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Mësimdhënia efektive dhe kurrikula (4 specializime MA); Teoritë kurrikulare (MA); Teori e mësimit dhe kurrikulës (MA); Teori e mësimit;
7. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Psikologji e zhvillimit të fëmijës (Ba EFH); Psikologji e edukimit (Ba EFH);
8. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Muzika për fëmijërinë e hershme (Ba EFH); Interpretim në instrumente (Ba EFH); Edukatë muzikore me metodologji (Ba Fillor).

V. FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDERTIMIT

1. Një profesor i angazhuar për ligjërata për lëndët: Baza e të dhënave, Matjet e tokës, Bazat e gjeodezisë inxhinierike, Teknika e matjeve në gjeodezi, Bazat e të dhënave gjeohapësinore dhe integrimi i të dhënave, Matjet inxhinierike (përfshihen minierat);
2. Një profesor i angazhuar për ligjërata për lëndët: Gjeologjia e ndërtimit dhe Gjeologjia inxhinierike;
3. Një lektor i angazhuar për lëndët: Gjuhë angleze;

4. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Mbrojtja dhe përforsimi i dherave, Fundimet e veçanta, Tunelet, Inxhinieria Gjeoteknike, Bazat e Gjeoteknikës, Projektimi i rrugëve K, Projektimi i rrugëve H, Gjeologjia inxhinierike, Inxhinieri gjeoteknike, Punët tokësorë dhe mekanizim;
5. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Teoria e strukturave I, Teoria e strukturave II, Analiza jolineare e strukturave, Stabiliteti i strukturave;
6. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Instrumente gjeodezike, Baza e të dhënave, Web hartografi, Bazat e të dhënave gjeohapësinore dhe integrimi i të dhënave, Web GIS, Bazat e Gjeodezisë inxhinierike, Matjet inxhinierike (përfshihen minierat), Teknika e matjeve në gjeodezi;
7. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Hartografi topografike, Hartografi, Bazat e GIS-it, Aplikimi i GIS-it, Hartografi matematike, Modelimi virtual kartografik, Gjeovizualizimi, Vrojtimi i Tokës;
8. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Përdorim i gjeoinformacioneve, Hulumtimet nga largësitë, Metodat e barazimeve, Regjistrimi dhe vlerësimi i patundshmërive, Teoria e avancuar e gabimeve, Shkenca e gjeoinformacionit dhe analiza hapësinore, Teknika e matjeve në gjeodezi;
9. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Mikrobiologjia ambientale (IA), Water and Conflicts (IWRM), Ndikimi i planifikimit urban në ambient (IA), Projektimi i deponive (IA), Hidrogeologjia (IA);
10. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Matematikë I (BSc K), Matematikë I (BSc H), Matematikë I (BSc IA), Algjebër Lineare (BSc Gj), Metodat numerike (BSc K), Gjeometri diferenciale (BSc Gj), Matematikë (BSc Ark), Matematikë II (BSc K), Matematikë II (BSc H), Matematikë II (BSc IA), Analizë matematikore (BSc Gj), Probabilitet (BSc K), Gjeometri llogaritëse (BSc Gj).

VI. FAKULTETI I MJEKËSISË

1. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Farmakologji me Toksikologji (MP),(Stom) (O), Farmakologji në infermieri (O);
2. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndën: Fiziologji mjekësore;
3. Dy asistentë të angazhuar për ushtrime për lëndën: Fiziologji patologjike;
4. Tre asistentë të angazhuar për ushtrime për lëndën: Oftalmologji;
5. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndën: Protetika paraklinike fikse, Protetika paraklinike mobile (BSc-O);
6. Tre asistentë të angazhuar për ushtrime për lëndët: Higjienë MP, Epidemiologji, Higjienë dhe Mjekësi Sociale –St, Shëndeti publik (Praktikë klinike);
7. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Kirurgji-IV (MP) (BSc-O), Kirurgji (Stom) (BSc-O), Kirurgji VI (MP-Praktikë klinike) (BSc-O);
8. Dy asistentë të angazhuar për ushtrime për lëndët: Statistike mjekësore me informatike MP (BSc-O), Mjekësi sociale MP (BSc-O), Shëndeti publik;
9. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndën: Onkologji (MP) (BSc-O);
10. Dy asistentë të angazhuar për ushtrime për lëndën: Anatomi patologjike;
11. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndën: Histologji me Embriologji.

VII. FAKULTETI I INXHINERISË MEKANIKE

1. Dy asistentë të angazhuar për ushtrime për lëndët e programit: Dizajn inxhinierik dhe automjete (Bsc dhe Msc);
2. Tre asistentë të angazhuar për ushtrime për lëndët e programeve: Termoenergjetikë dhe Energji e ripërteritshme (Bsc dhe Msc);
3. Dy asistentë të angazhuar për ushtrime për lëndët e programeve: Mekatronikë (Bsc dhe Msc);
4. Tre asistentë të angazhuar për ushtrime për lëndët e programeve: Komunikacion dhe Transport.

VIII. FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

1. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Programimi i pajisjeve mobile, Inxhinieria softuerike;
2. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Bazat e programimit, Algoritmet dhe strukturat e të dhënave;
3. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Mikroprocesorët dhe mikrokontrollerët, Robotika dhe automatizimi, Sistemet operative në kohë reale, Automatizimi i objekteve të banimit;
4. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Komunikimet elektronike, Elektronikë, Sistemet e dedikuara (BSc), Teknologjia VLSI, Qarqet mikroelettronike digjitale;
5. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Algjebër lineare me Kalkulus 1, Gjeometri analitike me Kalkulus 2, Probabilitet dhe statistikë;
6. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Algjebër lineare me Kalkulus 1, Gjeometri analitike me Kalkulus 2;
7. Një profesor i angazhuar për ligjërata: Praktikum në matematikë.

IX. FAKULTETI JURIDIK

1. Një profesor i angazhuar për ligjërata në lëndët e programit Master në gjuhën angleze “Human Rights, International Criminal Law and Transitional Justice”: Introduction to Transitional Justice (Semestri I, O); Cultural Heritage in Post-Conflict societies (cases from the region) (semestri I, Z); Civil Society and Transitional Justice (Semestri I, Z); Reconciliation and Right to truth (Semestri II, Z); Victims rights (Semestri II, Z).

X. FAKULTETI I ARTEVE

1. Një profesor i angazhuar për ligjërata në lëndën: Montazh në profile;
2. Një profesor i angazhuar për ligjërata për lëndët: Kamerë dhe fotografi në profile, Dizajn dritash.

XI. FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

1. Një profesor i angazhuar për ligjërata nga lëndët: Fisnikërimi i pemëve dhe hardhisë së rrushit, Biologjia dhe ekologjia e pemëve, Prodhimtaria e veçantë e frutave, Seleksionimi në hortikulturë dhe bimë frutore, Kultivimi organik i pemëve, Florikulturë (Zinxhiri i furnizimit me bimë);
2. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Bazat e pemëtarisë, Pemëtari speciale, Hyrje në shkencat pemëtare dhe vreshtare (pjesa e pemëtarisë), Prodhimi i fidanëve të pemëve dhe hardhisë së rrushit (pjesa e fidanëve të pemëve), Agropomoteknika, Biologjia dhe ekologjia e pemëve, Prodhimtaria e veçantë e frutave, Fisnikërimi i pemëve dhe hardhisë së rrushit, Seleksionimi në hortikulturë dhe bimë frutore, Natyra e fidanishteve të pemëve, Projekte interdisiplinare në pemëtari dhe vlerësimi i pemëve, Florikulturë (Zinxhiri i furnizimit me bimë), Kultivimi organik i pemëve dhe hardhisë;
3. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Bazat e vreshtarisë, Biologjia dhe fiziologjia e hardhisë së rrushit, Teknikat e kultivimit të cilësisë së lartë në vreshtari Ampelografia (Bsc. PB) Projekti: dizajni i mbjelljes, Ampelografia (Msc. PV), Prodhimi i fidanëve të pemëve dhe hardhisë së rrushit (pjesa e hardhisë së rrushit), Hyrje në shkencat pemëtare dhe vreshtare (pjesa e vreshtarisë);
4. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Teknologjia e përpunimit të pemëve dhe rrushit, Teknologjia e përpunimit të pemëve dhe perimeve, Teknologjia e prodhimeve alkoolike dhe joalkoolike;
5. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Gjenetikë e bimëve (Bsc. PB)-O (sem III), Hyrje në shkencën bimore I (Bsc. PB)_O (sem III), Bioteknologjia e bimëve (Bsc. TUBT) (Sem III), Seleksionimi për stres (MB Msc) (Sem III), Bimët foragjere (Bsc. PB)_O (Sem V), Hyrje në shkencën bimore II (Bsc. PB)_O (Sem IV), Përmirësimi gjenetik i bimëve (Bsc. PB)_O (Sem VI);
6. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Metoda e punës shkencore (Msc. LP)_O (sem I), Ujitja e bimëve bujqësore (Bsc. PB) - O (sem III), Menaxhimi në prodhim bimor (Msc) (Sem III), Teknologjia e pasvjeljes (Msc SHB) (Sem III);
7. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Higjiena dhe teknologjia e mishit, Siguria ushqimore dhe toksikologjia, Teknologjia e mishit dhe prodhimeve të tij, Mikrobiologjia dhe higjiena e ushqimit, Teknologjia e mishit dhe prodhimeve të mishit;
8. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Patologji I, Patologji II, Patologji III, Patologji IV, Parazitologji I, Parazitologji II, Epidemiologji me sëmundje infektive II;
9. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Obstetrika dhe riprodhimi I, Obstetrika dhe riprodhimi II;

10. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për grup lëndësh nga Biologjia veterinare, Histologjia I dhe Histologjia II;
11. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Farmakologji I, Farmakologji II, Mikologjia veterinare, Endokrinologjia klinike;
12. Një asistent i angazhuar për ushtrime për grup lëndët: Sëmundjet e brendshme I, Diagnostikë klinike, Diagnostikë laboratorike, Mirëqenia e kafshëve, Etologji aplikative, Bazat e ekzaminimit klinik;
13. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Bioteknologji e shtazëve (TUB-Bsc.), Bioteknologji animale (ShAZ-MSc);
14. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Tregu i ushqimit (Bsc EB), Hulumtimet sociale empirike (Bsc EB), Hyrje në ekonominë e ambientit dhe menaxhimi, Ekonomia Multifunksionale në bujqësi (Bsc PB), Ekonomia kompatible me prodhimtari bimorë dhe shtazore (Bsc. AE), Tregjet ndërkombëtare të mallrave dhe politikat e tregtimit, Puna edukative dhe projektuese, Parimet e hulumtimit cilësor dhe sasior mbi ekonominë dhe shkencat sociale (Msc EBU) , Zhvillimi i qëndrueshëm rural;
15. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Planifikimi në ndërmarrje (Bsc EB), Politikat bujqësore I, Financat në bujqësi, Bujqësia si degë e ekonomisë, Marketingu Bujqësor I, Ekonomia rajonale menaxheriale, Vlerësimi ekonomik i mallrave të tregut dhe burimeve natyrore, Teknikat e hulumtimit në punën shkencore, Ndërmarrësi në agrobiznes (Msc AE), Marketingu Bujqësor II;
16. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Kontabiliteti në fermat bujqësore, Hyrje në marketing, Vlerësimi i zhvillimit të qëndrueshëm rural (Bsc AE), Bankat dhe sistemi i kreditimit (Bsc AE), Statistikat në agroekonomi (Bsc. AE), Sigurimi i ushqimit dhe resurseve natyrore (Bsc EB), Bazat e ekonomisë (PSH), Statistika (Bsc PB);
17. Një asistent i angazhuar për mbajtjen e ushtrimeve në "Grup Lëndësh në fushën e prodhimit shtazor";
18. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Teknologjia e qumështit dhe prodhimeve të tij, Legjislacioni dhe menaxhimi i cilësisë, Kontrolli i prodhimeve ushqimore, Higjiena dhe teknologjia e qumështit, Teknikat e paketimit dhe ruajtjes së ushqimeve, Analizat sensorike (organoleptike) të ushqimeve, Teknologjia e qumështit dhe prodhimeve të tij - II, Teknologjia e pasvjeljes;
19. Një profesor i angazhuar për ligjërata dhe ushtrime për grup lëndët: Matematikë, Biomatematikë me biostatistikë;
20. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Botanikë, Bazat e Botanikës;
21. Një profesor i angazhuar për ligjërata për lëndët; Kontrolli biologjik dhe biodiversiteti - Msc O, Fitopatologji - Msc O, Akarologji me nematologji - Msc O, Mbrojtja e integruar - Bsc O, Diagnoza në patologjinë bimorë Msc Z;

22. Një asistent i angazhuar për ushtrime (MB): Hyrje në mbrojtje të bimëve I (PB)_O, Ekologjia e barojave (Msc. MB)_O, Legjislacioni në mbrojtjen e bimëve (Msc. MB) - O, Ekosistemet natyrore dhe antropogjene (Bsc. PB) - O, Mbrojtja e bimëve (Bsc. MBZ - O), Bazat e ekologjisë në bujqësi (Bsc. EB - Z);
23. Një asistent i angazhuar për ushtrime: Teknologjia e drithërave (Bsc O, TUB), Teknologjia dhe përpunimi i drithërave, pemëve dhe perimeve (Bsc O, TUB), Praktika (Bsc O, TUB), Biostatistika (Bsc O, TUB), Teknologjia e kulturave lavërtare (Msc Z, SHU), cilësia e bimëve (Msc, Z, LP);
24. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Biologji (Bsc O, TUBT), Biologji molekulare (Bsc O, TUBT), Bazat e të ushqyerit të njeriut (Msc O, TUBT), Gjenetikë e përgjithshme dhe bakteriale (Bsc Z, TUBT);
25. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Hyrje në shkencat animale (PB) - O, Bazat e hulumtimit shkencor (TUBT), Hyrje në shkencat animale (EB) - O, Teknikat e përpunimit, matjeve dhe automatizimit (Bsc. TUB) – O.

XII. FAKULTETI EKONOMIK

1. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Marketingu për kontabilistë; Biznesi komunikimi dhe kultura në marketing; Marketingu B2B; Marketingu 3.0; Promocioni; Dizajni i produktit; Sjellje konsumatore I; Kërkime marketingu; Menaxhimi i distribuimit; Marketingu në shitje me pakicë; Menaxhment i distribuimit; Marketingu ndërkombëtar; Strategjitë e marketingut; Vendimmartja në Marketing; Menaxhimi i raporteve me klientin;
2. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Bazat e marketingut; Marrëdhëniet me publikun; Marketingu; Marketingu; Marketingu i shërbimeve në institucionet financiare; Menaxhimi i brendit; Menaxhimi i mediave sociale; Marketingu i NVM-ve; Media marketingu dhe menaxhimi i mediave sociale; Menaxhimi i çmimeve; Menaxhimi i çmimeve; Marketingu në turizëm; Marketingu dhe përgjegjësia sociale; Menaxhimi i produkteve; Modelet e Marketingut; Marketingu në industrinë farmaceutike;
3. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Matematika financiare; Matematika për ekonomistë.
4. Një asistent i angazhuar për ushtrime për lëndët: Financat digjitale; Bazat e teknologjisë financiare; Financat publike; Vlerësimi financiar i bizneseve; Buxhetimi; Financat biheavioristike; Parimet financiare të projekteve; Financat.

